




ASIG prezanton monitorimin interaktiv të serrave bujqësore 2023–2025

ASIG, në mbështetje të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të institucioneve në varësi të saj, ka zhvilluar aplikacionin interaktiv “Monitorimi i serrave bujqësore 2023–2025”, i cili ofron një pasqyrë mbi shpërndarjen gjeografike, sipërfaqen dhe numrin e serrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, të organizuara sipas njësive të vetëqeverisjes vendore.

Përmes paraqitjeve grafike dhe analizave vizuale, aplikacioni mundëson identifikimin e bashkive me përqendrimin më të lartë të serrave, duke iu shërbyer institucioneve publike për monitorimin e këtij sektori. Të dhënat e paraqitura në këtë aplikacion i përkasin fazës aktuale të evidentimit dhe monitorimit të serrave bujqësore, proces i cili vijon ende në shkallë vendi.

I ndërtuar në platformën ArcGIS Online, aplikacioni ofron akses të shpejtë dhe informacion të besueshëm për politikën bujqësore dhe vendimmarrjen.



Dashboard-i Interaktiv:

“Monitorimi i serrave bujqësore 2023 - 2025”


Publikohet informacion gjeohapësinor për temën “Hidrografia”

ASIG në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar grupin e të dhënave gjeohapësinore “Status Ekologjik”, për temën “Hidrografia”.


Këto të dhëna janë gjeneruar nga Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore (PMBL) Ishëm dhe Erzen, miratuar përkatësisht me VKM nr. 624, datë 08.11.2023 dhe VKM nr. 623, datë 08.11.2023, për periudhën 2024 - 2029.

Informacioni gjeohapësinor përfaqëson statusin ekologjik të trupave ujorë sipërfaqësor, ku në klasifikimin e tyre përdoren ngjyra për të paraqitur vizualisht nivelin e cilësisë dhe shkallën e ndikimit njerëzor mbi ujërat.


Të dhënat janë konform standardit me VKM- në nr. 829, datë 07.10.2015, për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri-Tema: “Hidrografia”.



Rilevim me teknologjinë UAV Zonat Rrogozhinë dhe Peqin



DSM - Rrogozhinë



Izoipse - Peqin

Në funksion të përmirësimit të planifikimit urban dhe administrimit të territorit, ASIG ka kryer rilevime fotogrametrike të zonave urbane të qyteteve të Rrogozhinës dhe Peqinit me teknologjinë UAV (Unmanned Aerial Vehicle).

Rilevimi për Rrogozhinën mbulon një sipërfaqe prej 7.5 km², ndërsa për Peqinin një sipërfaqe prej 6.2 km², me rezolucion 4 cm, gjë e cila garanton cilësi të lartë dhe detaje të imta për analizat gjeohapësinore në mjedisin urban.

Në vijim të procesit, u krye edhe një mision fotografimi me metodën “oblique”, e cila mundëson imazhe me kënde të ndryshme, duke ofruar pamje reale dhe detaje të sakta të terrenit dhe objekteve.

Produktet e ofruara përfshijnë:

- Ortofoto;
- DSM (Modeli Digjital i Sipërfaqes);
- DTM (Modeli Digjital i Terrenit);
- Izoipse.

Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar




Rrugë Urbane - Rrogozhinë

ASIG ka përdorur teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360° për të realizuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar fotografimin “Rrugë urbane të qytetit të Rrogozhinës”, me një mbulim prej 30 km. Gjithashtu, janë fotografuar dhe “Rrugë urbane të qytetit të Peqinit”, me një gjatësi prej 27 km rrugë me pamje 360°. Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.

Zgjerimi i Hartës Bazë


Njësia Administrative Maqellarë

ASIG në cilësinë e Autoritetit Publik Përgjegjës për temën "Harta Bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të Njesisë Administrative Maqellarë. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 4 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.



Njësia Administrative Maqellarë

Publikohet Harta Aeronautike e Republikës së Shqipërisë - ICAO 1:500 000



Albcontrol, në bashkëpunim me ASIG, ka prodhuar hartën Aeronautike të Shqipërisë ICAO 1:500 000. Kjo hartë ofron informacion të detajuar për navigimin ajror vizual dhe përdoret gjithashtu për planifikimin para fluturimit, duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të operacioneve ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE


ASIG merr pjesë në Panairin e Karrierës 2026 në Universitetin POLIS

Më 26 mars 2026, në kuadër të promovimit të veprimtarisë së institucionit dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, ASIG mori pjesë në "Panairin e Karrierës 2026" në Universitetin POLIS.

Gjatë aktivitetit, përfaqësuesit e ASIG prezantuan veprimtarinë e institucionit dhe rolin e tij në administrimin dhe zhvillimin e informacionit gjeohapësinor në Shqipëri. Të rinjtë u informuan mbi mundësitë për zhvillim profesional, praktika në institucion, si dhe mbi proceset e ngritjes së kapaciteteve në këtë fushë. Pjesëmarrja e ASIG në këtë aktivitet kontribuoi në afrimin e të rinjve me sektorin e gjeoinformacionit dhe në nxitjen e interesit për teknologjitë dhe shërbimet gjeohapësinore.



ASIG merr pjesë në Munich Space Summit



Përfaqësues të ASIG morën pjesë në Munich Space Summit, i zhvilluar më 23–27 mars 2026 në Gjermani, një nga eventet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e hapësirës dhe teknologjive gjeohapësinore.

Ky aktivitet mbledhi aktorë kryesorë të industrisë, duke krijuar një platformë për diskutimin e zhvillimeve më të fundit dhe sfidave të sektorit, me fokus në inovacionin teknologjik, përdorimin e inteligjencës artificiale dhe rolin e të dhënave satelitore në mbështetje të vendimmarrjes. Pjesëmarrja e ASIG përbën një mundësi të rëndësishme për shkëmbim përvojash dhe forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë sektor strategjik.

TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Gjatë muajit mars 2026, ASIG organizoi një seri trajnimesh për stafet teknike të institucioneve publike, me fokus në standardizimin, përdorimin, menaxhimin dhe analizën e të dhënave gjeohapësinore. Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), u realizuan trajnimet me temat:

- “Infrastruktura Kombëtare e Ofrimit të të Dhënave dhe Shërbimeve Gjeohapësinore” – 5 mars 2026;
- “Aplikimet e Imazherisë Satelitore për Përpunimin e të Dhënave Gjeohapësinore” – 12 mars 2026;
- “Hyrje në Remote Sensing” – 26 mars 2026.

Në vijim të këtyre aktiviteteve, më 12 mars 2026, ASIG organizoi gjithashtu një trajnim për stafin teknik të Agjencisë Kombëtare Ujësjiellës-Kanalizime (AKUK), me fokus në menaxhimin dhe standardizimin e të dhënave gjeohapësinore për rrjetin e ujësjiellës-kanalizimeve, si dhe në përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Transferimi i të dhënave evropiane të Shërbimit Copernicus për Monitorimin e Tokës në Ekosistemin e të Dhënave Hapësinore Copernicus

Shërbimi Copernicus për Monitorimin e Tokës (Copernicus Land Monitoring Service-CLMS) ka nisur transferimin e portofolit evropian të të dhënave drejt Ekosistemit të të Dhënave Hapësinore Copernicus (Copernicus Data Space Ecosystem-CDSE), me synim përmirësimin e aksesit dhe përdorimit të të dhënave për monitorimin e tokës. Kjo nismë do t'ju mundësojë përdoruesve të gjejnë, shkarkojnë dhe përpunojnë më lehtë të dhënat përmes një platforme të vetme online. Në fazën e parë do të vihen në dispozicion të dhëna mbi përdorimin e tokës dhe pemët urbane, ndërsa në vijim do të shtohen edhe produkte të tjera të rëndësishme për monitorimin e tokës.

Konsorciumi i Hapur Gjeohapësinor ka filluar programin “Testbed on Trusted Data & Systems”

Konsorciumi i Hapur Gjeohapësinor (Open Geospatial Consortium-OGC) ka filluar programin “Testbed on Trusted Data & Systems”, një nismë që synon modernizimin e shërbimeve gjeohapësinore dhe rritjen e besueshmërisë së të dhënave zyrtare. Në partneritet me EuroGeographics, programi mbështet kalimin nga shërbimet tradicionale si WMS/WFS drejt ndërfaqeve moderne OGC API. Kjo nismë do të ndihmojë agjencitë kombëtare dhe ofruesit publikë të të dhënave të përmirësojnë interoperabilitetin, integrimin dhe përdorimin praktik të të dhënave gjeohapësinore.

AKTIVITETE NË VIJIM

Esri IMGIS Conference

Nga data 15–17 prill 2026, në Frankfurt, të Gjermanisë, Esri do të organizojë Konferencën Ndërkombëtare për Menaxhimin e Infrastrukturës dhe GIS (IMGIS). Ky aktivitet fokusohet në përdorimin e teknologjive të avancuara gjeohapësinore për të adresuar sfidat kryesore të infrastrukturës, duke përfshirë prezantime, workshop-e teknike dhe sesione interaktive për bashkëpunime profesionale dhe aftësi praktike.

15 - 17 Prill 2026

Geospatial World Forum (GWF)

Nga data 27 prill - 1 maj 2026, në Amsterdam, të Hollandës, do të zhvillohet Forumi Botëror Gjeohapësinor (GWF), me fokus “Sovraniteti, Ekonomia dhe Shoqëria”. Aktiviteti trajton rolin e të dhënave gjeohapësinore në sovranitetin digjital, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, si dhe përdorimin e tyre në fusha si planifikimi urban, infrastruktura, bujqësia dhe siguria publike.

27 Prill - 1 Maj 2026

Geo Symposium/ GEO-21 Plenary

Nga 26 - 28 maj 2026, në Gjenevë, të Zvicrës, do të zhvillohet GEO Symposium dhe GEO-21 Plenary, një aktivitet ndërkombëtar i fokusuar në përdorimin e “Earth Intelligence” për një të ardhme më të qëndrueshme. Ky event do të mbledhë aktorë qeveritarë, agjenci hapësinore, organizata kërkimore dhe sektorin privat për të diskutuar rolin e të dhënave gjeohapësinore në adresimin e sfidave globale.

26 - 28 Maj 2026

www.asig.gov.al

www.geoportal.asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: info@asig.gov.al